



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-130
Datë: 27.02.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ri-akreditohet "New Age School" me dy degë në Prishtinë, për periudhën **13.12.2016** deri **13.12.2021** për të ofruar:

1.1 Gjuhë Angleze

2. Ri-akreditimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

- 2.1 Nxënësve dhe stafit në të gjitha qendrat duhet t'u organizohet një simulim i situatës emergjente.
- 2.2 Në secilën qendër duhet të ketë kuti të sugjerimeve dhe sistem për mbledhjen dhe shqyrtimin e tyre.
- 2.3 Numri i bombolave të gazit të shtohet në qendrën 1 dhe 2.

- 3 Kushtet e parashtruara për ri akreditim duhet të përmbushen deri më datën **30.03.2017**, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi u dërgohet:

- New Age School;
- AKK.



Anëtari i KD së AKK-së
Bedri Xhafa